

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri anëtarë, në çështjen juridike të paditëses N.T.SH “H.- B” me seli në ..., të cilën e përfaqëson A.S., pronar i ndërmarrjes, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit të cilën e përfaqëson Bilbil Oruqi për borxhe për shkak të mos përmbushjes së kontratës duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.4860/14 datë 06.08.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.12.2018 morri këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në Prishtinë Ac.nr.4860/14 datë 06.08.2018.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4860/14 datë 06.08.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditurës Komuna e Rahovecit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakove-Dega në Rahovec me të cilin nën pikën I të dispozitivit miratohet kërkesëpadia e paditëses N.T.SH. “ H- B” me seli në ..., dhe detyrohet e paditura Komuna e Rahovecit që për shkak të mos përmbushjes së kontratës t’ia paguaj paditëses në emër të borxhit shumën prej 4.782 € me kamat ligjore sipas mjeteve të deponuara pa destinim të caktuar duke filluar prej datës 30.06.2010 e deri te pagesa definitive të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si e bazuar. Nën pikën II të dispozitivit detyrohet e paditura që po të njëjtin afat paditëses t’ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumë prej 150.00 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizion të aprovohet si i bazuar dhe që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e goditur dhe pretendimet e revizionit dhe pas vlerësimit të tyre në kuptimi të nenit 215 të LPK-së, gjeti se :

Revizioni i të paditurës është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja me datë ..., ka lidhur marrëveshjen me shkrim me të paditurën për mirëmbajtjen e kamionëve dhe aparateve kundër zjarrit. Me nenin 1 të kësaj marrëveshje palët janë marr vesh që për shërbimet që do të kryejnë, kompensimi financiar do të kryhet sipas faturave të plotësuara dhe të sjellur nga paditësja N.T.SH. “ H.- B.”, nga ..., Me nenin 2 të kësaj marrëveshje është përcaktuar edhe periudha kohore për kryerjen e punëve nga 09.07.2009 dhe do të zgjatë deri me 09.07.2010. Paditësja ka përmbushur detyrimin e vet por e paditura i ka mbetur borxh paditëses shumen prej 4.782.00 € që shihet nga faturat numër 15,16, si dhe nga ekspertiza e ekspertit të makinerisë A. S., për çfarë arsye paditësja përmes gjykatës kërkon përmbushjen e detyrimit nga e paditura në kuptim të marrëveshjes së lartpërmendur.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike e aprovon kërkesëpadinë e paditëses duke e detyruar të paditurën në përmbushjen e detyrimit nga marrëveshja e lartcekur e në kuptim të dispozitës së nenit 122 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetua drejt dhe në mënyrë të plot gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, refuzon si të pa bazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët në bazë të vërtetimit të plot të gjendjes faktike kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale. Aktgjykimi i goditur me revizion dhe ai i shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare. Gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhen arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejt të kësaj çështje juridike të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Në bazë të nenit 17 të Ligjit mbi marrëdhëniet Detyrimore pjesëmarrësit e marrëdhënies detyrimit kanë për detyrë të zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e detyrimit kështu që marrëveshja e ndërgjygjësve me të cilën palët kontraktues janë marrë vesh për pjesë përbërëse esenciale është kontratë për palën dhe e njëjta krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese sikur është parashikuar me nenin 148 paragrafi 1 të LMD-së. Në bazë të nenit 124 të këtij ligji është parashikuar se në kontrata dy palësh, kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet nëse nuk është caktuar ndryshe të kërkon përmbushjen e detyrimit ose nën kushtet e caktuara me ligj me deklaratë të thjesht ta zgjidh kontratën, nëse zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vet ligjit e në çdo rast ka të drejt në kompensimin e dëmit. Kështu në bazë të kësaj dispozite paditësja si palë kontraktuese ka dy autorizime, të kërkon nga e paditura përmbushjen e kontratës ose zgjidhjen e kontratës, por pasi që paditësja e ka përmbushur detyrimin e vet me të drejt ka kërkuar që e paditura po ashtu të përmbush detyrimin e vet dhe me të drejt është aprovuar kërkesëpadia e paditëses nga ana e gjykatës së shkallës së parë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuar dhe irelevante thëniet e të paditurës në revizion për mos zbatimin e rregullt të dispozitave të Ligjit për menaxhimin e financave publike për arsye se respektimin e dispozitave të këtij ligji ka qen dashtë të bëjë e paditura dhe se kjo çështje është irelevante sa i përket paditëses e cila i ka përmbushur detyrimet e veta nga marrëveshja e lidhur mes ndërgjygjësve me datë 09.07.2009. Prandaj gjykatat e instancës me të ultë drejt kanë zbatuar edhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga sa u tha më sipër Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat është paraqitur revizioni dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.408/2018 datë 1012.2018

Kryetar i kolegjit

Isa Kelmendi

